



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 0508.2013
Nr.0204-14/14

PËR Ramadan Muja, Kryetari i Komunës së Prizrenit
Njazi Kryeziu, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË
KOMUNËS SË PRIZRENIT, NR.01/011-8405

Pranuar me datë: 24.07.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit, KONSTATON se:

- Vendimi Nr.01/011-8405, e datës, 04.07.2013, për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të Pronës Komunale të komunës së Prizrenit, është në kundërshtim të nenit 6 paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që, Vendimi Nr. 01/011-8405 i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale, të harmonizohet me dispozitat ligjore, nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorëve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 0508.2013
Br.0204-14/14

Za Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Njazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine Opštine Prizren

**PREDMET: ZAHTEV ZA PONOVO RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE
OPŠTINE PRIZREN
, BR.01/011-8405**

Primljeno dana: 24.07.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti akata, **KONSTATUJE:**

- Odluka br.01/011-8405, od dana, 04.07.2013, o Davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštine imovine Opštine Prizren, je u suprotnosti sa članom 6 paragraf 3 Zakona Br.04/L-144 o Davanju na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o lokalnoj samoupravi *traži* od Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Prizren da preuzmu konkretne mere da, Odluka Br. 01/011-8405 Skupštine Opštine Prizren, za Davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, da se uskladi sa zakonskim dispozicijama, člana 6 Zakona br.04/L-144 za Davanje na korišćenja i razmenu nepokretne opštinske imovine, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za ponovno razmotrenje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopje: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima Uprava i Kancelarija MALS-a
Arhivi MALS-a.

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 7 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të shkresës së MAPL, Nr. 01014, të datës 31 janar 2013, për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit për ndarjen e truallit në shfrytëzim nr. 01/011-12258, të datës 18 tetor 2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2013, mori këtë:

V E N D I M

PËR RIKONFIRMIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, TË DATËS 18 TETOR 2012, Nr.01/011-12258 MBI NDARJEN E TRUALLIT NË SHFRYTËZIM

“Neni 1”

Rikonfirmohet vendimi i Kuvendit nr. 01/011-12258 , të dates 18 tetor 2012, për ndarjen e truallit në shfrytëzim me tekstin në vijim:

Neni 1

Aprovohet propozimi i Komisionit Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, ashtu që lejohet dhënia në shfrytëzim e ngastrës kadastrale nr.7362/2 ZK Prizren.

Neni 2

Ngastra kadastrale nr.7362/2 ZK Prizren në vendin e ashtuquajtur „Dardania-2”, e cila është objekt i dhënies në shfrytëzim me këtë vendim, sipas kopjes së planit të dt;21.06.2013, është në sipërfaqe prej 195 m², dhe evidentohet si pasuri shoqërore KK Prizren, dhe e cila ngastër është në kuadrin e ngastrave të caktuara për personat e riatdhesuar sipas Konkluzionit të Kryetarit të Komunës nr.01/06-1595, të datës 21.02.2012 si dhe në pajtim me memorandumin e nënshkruar nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Neni 3

Prona në fjalë e përshkruar si në nenin 1 dhe 2, jepet me qëllim të ndërtimit të shtëpisë familjare për banim për parashtruesin e kërkesës së Shaban Braha si person i riatdhesuar (veteran i luftës).

Neni 4

Afati kohor për ndarjen e truallit pronë komunale, do të jetë konform nenit 6 të Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (99 vite).

Përfitimi i Komunës do të jetë zgjidhja e problemit të banimit për personin e riatdhesuar dhe në të njëjtën kohë me këtë vendim do të përfitojnë dhe institucionet qendrore ngase do të realizohet dhe Memorandumi i nënshkruar nga të njëjtat me Unionin Evropian për zgjidhjen e çështjes banesore për persona e riatdhesuar.

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES VLADYNSKOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Psehtott Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data		24.07.2013	
Datum		Date	
Hjësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- 37 -	0204-14/14		

Neni 5

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës që pas marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit të Komunës të merr Aktvendim për ndarjen e truallit pronë komunale parashtruesit të kërkesës Shaban Braha.

Neni 6

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori për Çështje Pronësore-Juridike dhe Avokati Publik Komunal.
Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

ARSYETIM


Shaban Braha është drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës, Zyrës për Komunitete dhe Kthim si dhe Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor për ndarjen e truallit-Pronë Komunale në cilësinë e personit të riatdhesuar e përshkruar si më lartë.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të tjera të lëndës ka vërtetuar se personi i lartpërmendur i plotëson të gjitha kushtet për ndarjen e një ngastre kadastrale – pronë komunale që i njëjti të e siguroj strehimin dhe banimin për atë dhe familjen e tij.


Me ndarjen e truallit pronë komunale Shaban Braha si person i riatdhesuar-veteran i luftës, Komuna e Prizrenit zbaton marrëveshjen në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për zgjidhjen e çështjes banesore për persona e riatdhesuar.

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-8405
Më 4 korrik 2013
Prizren


REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Drejtoria e Administrimit dhe e Personelit
Direktorijat në Administratën e Personalit
Verilica • Personal Mudariogu

01/011 ... 8405 Dt. 18.07.2013



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu